




Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 25.01.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4675/16, për z. Milazim Bytyçi, Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike Infrakos Sh.A, për shkak se zyrtari i lartë publik e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Milazim Bytyçi, Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike Infrakos Sh.A, dhe njëkohësisht menaxher (person i autorizuar) në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese kemi njoftuar zyrtarin e lartë për gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej dhe për ndryshimet që duhet ti bëjë për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit

Zyrtari i lartë z. Bytyçi, është deklaruar se do të heq dorë nga ushtrimi i funksionit menaxherial në biznes privat sipas rekomandimit të dhënë nga Agjencia, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar një shkresë zyrtare (DPKI.03-02/96/17), me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë është larguar nga funksioni menaxherial në biznesin privat D.P.T “Dreni”.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtori Agjencisë kundër Korrupsionit

